<p>(babai, nëna, kujdestari ligjor, vëllai, motra, djali, vajza, bashkëshorti ose bashkëshortja);</p> <p>3.3. Personi i autorizuar nga pala me prokurë përfaqësimi të noterizuar.</p> <p style="text-align: center;">Neni 9 Verifikimi i origjinës së dokumentit publik</p> <p>1. Me lëshimin e një dokumenti publik të Apostilizuar, Autoriteti Kompetent certifikon:</p> <p>1.1. Autenticitetin e nënshkrimit në dokumentin publik të paraqitur;</p> <p>1.2. Kapacitetin e veprimit të zyrtarit publik dhe pozitën e tij/saj;</p> <p>1.3. Identitetin e vulës dhe të dhënave tjera publike që përmban dokumenti publik.</p>	<p>mother, legal guardian, brother, sister, son, daughter, spouses) with notarized authorisation or with the declaration of family community;</p> <p>3.3. The person authorized by the party with a notarized proxy.</p> <p style="text-align: center;">Article 9 Verification of origin of the public document</p> <p>1. With the issuance of apostilled public document, the Competent Authority certifies:</p> <p>1.1. Authenticity of the signature in the submitted public document;</p> <p>1.2. Capacity of the public official and his/her position;</p> <p>1.3. Identity of the stamp and other public data contained in the public document.</p>	<p>majka, zakonski staratelj, brat, sestra, sin, ćerka, muž ili žena);</p> <p>3.3. Ovlašćeno lice od stranke sa overenim pravom zastupanja.</p> <p style="text-align: center;">Član 9 Provera porekla javnog dokumenta</p> <p>1. Sa izdavanjem javnih Apostiliranih dokumenata, nadležni organ potvrđuje:</p> <p>1.1. Autentičnost potpisa na podneseni javni dokument;</p> <p>1.2. Kapacitet delovanja javnog službenika i njegov/njen položaj;</p> <p>1.3. Identitet pečata i drugih javnih podataka koje sadrži javni dokument.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 10 Certifikata Apostile</p> <p>1. Certifikata e vetme dhe unike e cila do</p>	<p style="text-align: center;">Article 10 Apostille certificate</p> <p>1. The only and unique certificate to be</p>	<p style="text-align: center;">Član 10 Sertifikat Apostille</p> <p>1. Jedini i jedinstveni sertifikat koji će biti</p>

<p>lëshohet nga Autoritetet Kompetente në Republikën e Kosovës do të jetë në formën e një katrori me brinjë jo më të vogla se 9 cm e karakterizuar me stemën e Republikës së Kosovës në prapavijë dhe me elementet e nevojshme të sigurisë sipas standardeve të sigurisë për dokumentet publike.</p> <p>2. Certifikata Apostile, është pjesë përbërëse e kësaj Rregulloreje dhe paraqitet në Shtojcën I.</p> <p>3. Certifikata model e paraqitur në Shtojcën I, vendoset nga zyrtari i autorizuar i Autoriteteve Kompetente, për së gjati në një qoshe/kënd të dokumentit të Apostiluar.</p> <p>4. Certifikata do të lëshohet në gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në gjuhën angleze. Titulli i certifikatës do të jetë në frëngjisht.</p> <p>5. Teksti plotësues i certifikatës Apostile, i paraqitur në Shtojcën I është pjesë përbërëse e kësaj Rregulloreje dhe e njëjta paraqitet në gjuhët zyrtare. Teksti duhet të vendoset poshtë modelit standard të certifikatës dhe nuk duhet të ndërhyjë në integritetin e përmbajtjes standarde prej 10 pikave në certifikatën model.</p>	<p>issued by the Competent Authorities in the Republic of Kosovo will be in the square shape with sides not less than 9cm, characterized with the emblem of the Republic of Kosovo in the background and with necessary security elements for public documents.</p> <p>2. The Apostille certificate is an integral part of this Regulation and is presented in Annex I.</p> <p>3. Model certificate presented in Annex I is placed lengthwise by the authorized official of Competent Authorities in the corner of apostilled document.</p> <p>4. The certificate shall be issued in the official languages of the Republic of Kosovo and English language. The title of the certificate shall be in the French language.</p> <p>5. Supplementary text of the apostille certificate presented in the Annex I is integral part of this Regulation and the same is presented in the official languages. The text should be placed under the standard model of certificate and shall not interfere in the integrity of the standard content of 10</p>	<p>izdat od strane nadležnih organa Republike Kosovo će biti u obliku kvadrata sa stranama ne manjim od 9 cm, karakterizovana grbom Republike Kosovo u pozadini i sa neophodnim elementima bezbednosti u skladu sa bezbednosnim standardima za javne dokumente.</p> <p>2. Sertifikat Apostille, je sastavni deo ove Uredbe i prikazan je u Aneksu I.</p> <p>3. Model sertifikata koji je prikazan u Aneksu br. I, postavljen je od strane ovlašćenog službenika nadležnih organa, po dužini na uglu/strani Apostiliranih dokumenata.</p> <p>4. Sertifikat će biti izdat na službenim jezicima Republike Kosovo i na engleskom jeziku. Naslov sertifikata će biti na francuskom jeziku.</p> <p>5. Dopunski tekst sertifikata Apostille, prikazan na Aneksu I je sastavni deo ove Uredbe i ista se predstavlja na službenim jezicima. Tekst treba da bude postavljen ispod standardnog modela sertifikata i ne treba da utiče na integritet standardnog sadržaja od 10 tačaka u modelu sertifikata.</p>
--	--	---

<p>6. Zyrtari i autorizuar pasi të ketë verifikuar vërtetësinë e origjinës së dokumentit publik për të cilën është parashtruar kërkesa për lëshim të Apostilës, plotëson të dhënat e nevojshme në 10 fushat informative të specifikuara si në modelin e certifikatës. Çdo fushë duhet të plotësohet me të dhënat e disponueshme. Asnjë fushë e certifikatës nuk duhet të lihet e zbrazët, përveç në rastet kur një fushë nuk është e aplikueshme, atëherë duhet të shënohet; <i>‘nuk aplikohet’ ose ‘n/a’.</i></p> <p>7. Organet kompetente duhet të shqyrtojnë kërkesën e palës sa më shpejtë që të jetë e mundur, por jo më vonë se tre (3) ditë nga momenti i dorëzimit të kërkesës për lëshimin e certifikatës Apostille.</p> <p>8. Në rast të refuzimit të kërkesës së palës, zyrtari përgjegjës i Autoritetit Kompetent, obligohet të lëshoj njoftim me shkrim me arsyet e refuzimit.</p> <p style="text-align: center;">Neni 11 Regjistrimi i Apostilës</p> <p>1. Çdo certifikatë apostile e lëshuar duhet të</p>	<p>points in the model certificate.</p> <p>6. The authorized official, after verifying the validity of the origin of public document for which a request for issuing the apostille has been submitted, fills all necessary data in 10 informational fields, as specified in the model of the certificate. Every field should be filled with available data. No field of the certificate should be left blank, unless a field is not applicable, then it should be written as <i>‘not applicable’ or ‘n/a’.</i></p> <p>7. The competent authorities shall consider the request of the party as soon as possible, but no later than three (3) days of submission of application for issuance of a Certificate Apostille.</p> <p>8. In case of rejection of the party’s request, the responsible official of the Competent Authority shall be obliged to issue a written notification of the reasons for rejection.</p> <p style="text-align: center;">Article 11 Apostille registration</p> <p>1. Every issued apostille certificate shall be</p>	<p>6. Ovlašćeni službenik nakon izvršene provere autentičnosti porekla javnog dokumenta za koju je podnesen zahtev za izdavanje Apostille, popunjava potrebne podatke u 10 informativnih oblasti kao što je navedeno u modelu sertifikata. Svako polje mora da bude popunjeno sa raspoloživim podacima. Nijedno polje sertifikata ne sme da ostane prazno, osim u slučaju kada polje nije primenjivo, tada treba da se piše; <i>‘nije primenjivo’ ili ‘n/p’.</i></p> <p>7. Nadležni organi trebaju razmotriti zahtjeva podnosilaca zahtjeva u najkraćem mogućem roku, a najkasnije u roku od tri (3) dana od podnošenja zahtjeva za izdavanje sertifikata Apostille,</p> <p>8. U slučaju odbijanja zahteva stranke, odgovorni službenik nadležnog organa je dužan je izdaje pismeno obaveštenje o razlozima odbijanja.</p> <p style="text-align: center;">Član 11 Registrovanje Apostille</p> <p>1. Svaki izdati Apostille mora biti evidentiran</p>
---	--	---

<p>evidentohet në Regjistrin Qendror nga zyrtari përgjegjës i Autoritetit Kompetent përkatës.</p> <p>2. Procedurat e regjistrimit, qasjes, kufizimeve dhe administrimit në cilësinë e Administratorit apo përdoruesit të autorizuar të Regjistrin Qendror do përcaktohen me Udhëzuesin e Përdorimit të Regjistrin dhe Procedurave Standarde të Operimit të zhvilluar dhe aprovuar nga Autoritetet Kompetente.</p> <p>3. Zyrtarët e autorizuar, duhet të sigurohen që çdo certifikatë apostile e lëshuar t'i ketë dhënat e mëposhtme:</p> <p>3.1. Numrin rendor të certifikates apostile të lëshuar;</p> <p>3.2. Datën e lëshimit të certifikates apostile;</p> <p>3.3. Emrin dhe mbiemrin e zyrtarit që ka nënshkruar dokumentin publik;</p> <p>3.4. Pozitën e zyrtarit që ka nënshkruar dokumentin publik;</p>	<p>recorded in the Central Register by the responsible official of the relevant Competent Authority.</p> <p>2. Procedures of registration, access, restrictions and administration in the capacity of the administrator or authorized user of the Central Register will be determined in the Manual on Use of Register and Standard Operating Procedures, developed and approved by the Competent Authorities.</p> <p>3. Authorized officials shall ensure that every apostille issued contains the following data:</p> <p>3.1. Ordinal number of issued apostille;</p> <p>3.2. Date of issuance of apostille;</p> <p>3.3. Name and surname of the official who signed the public document;</p> <p>3.4. Position of the official who signed the public document;</p>	<p>u Centralnom registru od strane odgovornog službenika relevantnog nadležnog organa.</p> <p>2. Procedure registrovanja, pristupa, ograničenja i upravljanja u svojstvu administratora ili ovlašćenog korisnika Centralnog registra će se utvrditi uputstvom za upotrebu Registra i standardnih operativnih procedura, razvijenih i odobrenih od strane nadležnih organa.</p> <p>3. Ovlašćeni službenici, treba da se osiguraju da svaki izdati Apostille sadrži sledeće podatke;</p> <p>3.1. Redni broj izdatog Apostille;</p> <p>3.2. Datum izdavanja Apostille;</p> <p>3.3. Ime i prezime službenika koji je potpisao javni dokument;</p> <p>3.4. Poziciju službenika koji je potpisao javni dokument;</p>
---	--	--

<p>3.5. Në rast të dokumentit publik të panënshkruar, të dhënat mbi emërtimin e organit/institucionit publik i cili e ka vulosur dokumentin.</p> <p>4. Autoritetet Kompetente për nevoja të statistikave të ndryshme mund të regjistrojnë së paku të dhënat shtesë si në vijim:</p> <p>4.1. Natyrën e dokumentit publik; dhe</p> <p>4.2. Emrin e shtetit të destinimit (pranimit) të certifikatës apostile.</p> <p>5. Të dhënat përpunohen në përputhje me Ligjin Nr.03/L-172 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.</p>	<p>3.5. If the public document is unsigned, data on the name of the public body/institution which has stamped the document.</p> <p>4. Competent Authorities, for the needs of different statistics, may register at least the following additional data;</p> <p>4.1. Nature of public document; and</p> <p>4.2. Name of destination (receiving) state of apostille.</p> <p>5. Data are processed in compliance with the Law No. 03/L-172 on Protection of Personal Data.</p>	<p>3.5. U slučaju nepotpisanog javnog dokumenta, treba upisati podatke o nazivu organa/javne institucije koja je overila dokumenat.</p> <p>4. Nadležni organi za potrebe različitih statističkih podataka mogu registrovati barem sledeće dodatne informacije;</p> <p>4.1. Prirodu javnog dokumenta; i</p> <p>4.2. Naziv države odredišta (primanja) Apostille.</p> <p>5. Podaci se obrađuju u skladu sa Zakonom br. 03/L-172 o zaštiti ličnih podataka.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 12 Bashkëpunimi dhe Koordinimi</p> <p>1. Organet e administratës shtetërore përgjegjëse për lëshimin e dokumenteve publike, duhet të bashkëpunojnë ngushtë me autoritetet kompetente të përcaktuara në këtë Rregullore dhe të shkëmbejnë të dhënat dhe informacionin e nevojshëm për ushtrimin e funksionit të tyre për lëshimin e certifikatës apostile.</p>	<p style="text-align: center;">Article 12 Cooperation and coordination</p> <p>1. State administration bodies responsible for issuing the public documents shall cooperate closely with competent authorities stipulated in this Regulation and exchange necessary data and information for exercising their function for issuing the apostille certificate.</p>	<p style="text-align: center;">Član 12 Saradnja i koordinacija</p> <p>1. Organi državne uprave koji su nadležni za izdavanje javnih dokumenata, treba blisko da sarađuju sa nadležnim organima utvrđenim u ovoj Uredbi i da razmene podatke i potrebne informacije za vršenje njihove funkcije za izdavanje sertifikata apostille.</p>

<p>2. Autoritetet kompetente, duhet të bashkëpunojnë me organet kompetente të gjyqësorit, për çështje me interes të përbashkët që lidhen me zbatimin e legjislacionit në fuqi për lëshimin dhe autentifikimin e dokumenteve publike që lëshohen nga institucionet e Gjyqësorit.</p> <p>3. Për realizimin e plotë, efikas, të gjithanshëm dhe të vazhdueshëm të bashkëpunimit reciprok, Autoritetet kompetente do t'i rregullojnë në hollësi procedurat e bashkëpunimit me organet kompetente të gjyqësorit me marrëveshje bashkëpunimi.</p> <p>4. Autoritetet kompetente, bashkëpunojnë me Autoritetin në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale.</p> <p style="text-align: center;">Neni 13 Lista e dokumenteve</p> <p>Me vendim të Ministrave përkatës të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme caktohet lista e dokumenteve që i nënshtrohet procesit të apostilimit.</p>	<p>2. Competent authorities shall cooperate with judicial competent bodies on issues of common interest related to the implementation of applicable legislation concerning the issuance and authentication of public documents issued by judicial institutions.</p> <p>3. For a full, efficient, comprehensive and continuous cooperation, Competent Authorities, with a cooperation agreement, shall regulate in details the cooperation procedures with judicial competent bodies.</p> <p>4. Competent Authorities shall cooperate with the authority in the field of protection of personal data.</p> <p style="text-align: center;">Article 13 List of Documents</p> <p>The list of the documents that will be apostilized, will be determined by the decision of the relevant Ministers of the Ministry of Foreign Affairs and the Ministry of Internal Affairs.</p>	<p>2. Nadležni autoriteti treba sa saraduju sa nadležnim organima pravosuđa, o pitanjima od zajedničkog interesa u vezi sa sprovođenjem važećeg zakona za izdavanje i autentičnost javnih dokumenata izdatih od strane pravosudnih institucija.</p> <p>3. Za punu realizaciju, efikasnu, sveobuhvatnu i kontinuiranu međusobnu saradnju, nadležni autoriteti će detaljno regulisati procedure saradnje sa nadležnim organima pravosuđa, sa sporazumima o saradnji.</p> <p>4. Nadležni autoriteti saraduju sa Autoritetom u oblasti zaštite ličnih podataka.</p> <p style="text-align: center;">Član 13 Popis dokumenata</p> <p>Odlukom od nadležnih ministara u Ministarstvu vanjskih poslova i Ministarstva unutarnjih poslova utvrđuje popis dokumenata predmet apostilimit.</p>
--	---	--

<p style="text-align: center;">Neni 14 Tarifat për shërbimet e Apostilës</p>	<p style="text-align: center;">Article 14 Tariffs for apostille services</p>	<p style="text-align: center;">Član 14 Takse za usluge Apostille</p>
<p>1. Tarifa unike e aplikuar në nivel vendi, nga Autoritetet kompetente për shërbimet e lëshimit të certifikatës apostile për të gjitha dokumentet publike që paraqiten me kërkesë për marrjen e certifikatës apostile, është e përcaktuar në vlerën nominale prej dhjetë eurove (10.00 €).</p> <p>2. Zyrtari i autorizuar pranë Autoritetit Kompetent, pas kryerjes së procedurave të verifikimit të dokumentit, obligohet që t'i kryej veprimet e parapara me paragrafët 5 deri me 11 të nenit 5 të kësaj Rregullore dhe kryej verifikimin e pagesës së kryer.</p> <p>3. Pagesa kryhet në dhe për llogari të Buxhetit të Kosovës.</p> <p>4. Nga pagesa për marrjen e certifikatës apostile të dokumenteve publike të lëshuara nga Autoritetet kompetente, lirohen personat e sëmurë për tu dërguar për shërim jashtë vendit të cilët e dokumentojnë me dokumentet përkatëse rekomandimin e konsiliumit të mjekëve të autorizuar apo Ministrisë së Shëndetësisë.</p>	<p>1. Unique tariff applied at the country level by the Competent Authorities for the apostille services for all public documents submitted with the request for obtaining the apostille certificate is determined in the nominal value of ten Euro (€10.00).</p> <p>2. The authorized official of the Competent Authority, following the procedures for verification of document, shall be obliged to perform actions provided for in the paragraphs 5 until 11 of the Article 5 of this Regulation and verify the payment.</p> <p>3. The payment shall be made to and in the account of Kosovo Budget.</p> <p>4. Diseased persons seeking medical treatment abroad, who prove with relevant documents the recommendation of the council of authorized doctors or Ministry of Health, shall be exempted from the payment for obtaining the apostille certificate of public documents issued by Competent Authorities.</p>	<p>1. Jedinstvena taksa koja se primenjuje na nivou zemlje, od strane nadležnih organa za usluge Apostille za sva javna dokumenta koja se podnose sa zahtevom za dobijanje sertifikata Apostille, je utvrđena u minimalnom iznosu od deset evra (10.00 €).</p> <p>2. Ovlašćeni službenik nadležnog organa, nakon završetka procedura za proveru dokumenata, dužan je da izvrši radnje predviđene stavom 5 do 11 člana 5 ove Uredbe i izvrši proveru plaćanja.</p> <p>3. Plaćanje se vrši u i za račun budžeta Kosova.</p> <p>4. Od plaćanja za dobijanje sertifikata Apostille javnih dokumenata izdatih od strane nadležnih organa, izuzimaju se bolesne osobe kojima je potrebno lečenje van zemlje koji potvrđuju sa relevantnim dokumentima preporuku ovlašćenog lekarskog konzilijuma ili Ministarstva zdravstva.</p>

<p>5. Familjet e dëshmorëve, invalidëve dhe veteranëve të luftës lirohen nga pagesa për marrjen e certifikatës apostile, ashtu siç përcaktohet me Ligjin në fuqi.</p> <p>6. Personat të cilët gëzojnë të drejtën e lirimit nga tarifa e shërbimit, si të përcaktuar me kategoritë e specifikuar në paragrafët 4 dhe 5 duhet të paraqesin dëshmitë e nevojshme.</p> <p style="text-align: center;">Neni 15 Dispozitat Kalimtare</p> <p>1. Autoritetet kompetente, brenda gjashtë (6) muajve nga hyrja në fuqi e kësaj Rregulloreje zhvillojnë dhe funksionalizojnë sistemin e Regjistrimit Qendror i cili përmban edhe nënshkrimet mostër (specimenet) dhe vulat në përdorim nga organet tjera të autorizuar publike për lëshimin e dokumenteve publike.</p> <p>2. Autoritetet kompetente, brenda gjashtë (6) muajve nga hyrja në fuqi e kësaj Rregullore aprovojnë procedurat e regjistrimit, qasjes, kufizimeve dhe administrimit në kapacitetin e Administratorit apo Përdoruesit të Autorizuar të Regjistrimit Qendror të përcaktuara në Udhëzuesin e Përdorimit të Regjistrimit dhe Procedurave Standarde të Operimit.</p>	<p>5. Families of martyrs, invalids and war veterans shall be exempted from the payment for obtaining the apostille certificate, as provided for under the applicable law.</p> <p>6. Persons entitled to exemption from the service tariff, as determined in the categories specified in paragraphs 4 and 5, shall provide the necessary evidences.</p> <p style="text-align: center;">Article 15 Transitional provisions</p> <p>1. Competent Authorities shall within six (6) months following the entry into force of this Regulation develop and functionalize the Central Register system containing specimens and stamps being used by other public authorized bodies for issuing public documents.</p> <p>2. Competent Authorities shall within six (6) months following the entry into force of this Regulation approve procedures of registration, access, restrictions and administration in the capacity of the administrator or authorized user of the central register determined in the Manual on Using the Register and Standard Operating</p>	<p>5. Porodice palih boraca, invalida i ratnih veterana oslobođeni su od plaćanja sertifikata Apostille, kako je navedeno važećim zakonom.</p> <p>6. Osobe koje uživaju pravo na oslobođanje od taksi za usluge, kao što je određeno po navedenim kategorijama u stavovima 4 i 5 treba da dostave potrebne dokaze.</p> <p style="text-align: center;">Član 15 Prelazne odredbe</p> <p>1. Nadležni organi, u roku od šest (6) meseci od stupanja na snagu ove Uredbe vrše razvoj i stavljaju u funkciju sistem Centralnog registra koji sadrži i primerke potpisa (uzoraka) i pečate na korišćenju od strane drugih ovlašćenih organa za izdavanje javnih dokumenata.</p> <p>2. Nadležni organi, u roku od šest (6) meseci od stupanja na snagu ove Uredbe, usvajaju procedure za registrovanje, pristupanje, ograničenja i upravljanja u svojstvu administratora ili ovlašćenog korisnika centralnog registra i standardnih operativnih procedura.</p>
--	--	--

<p>3. Ministria e Punëve të Jashtme dhe Ministria e Punëve të Brendshme, nxjerrin akte nënligjore që rregullojnë procedurat e verifikimit dhe legalizimit të dokumenteve publike për gjitha ato kërkesa ku shtet i destinacionit (pranimi) do të jenë shtetet që kanë paraqitur ‘kundërshtime’ për aderimin e Republikës së Kosovës në Konventën Apostile si dhe për shtetet jo-anëtare të kësaj Konvente.</p> <p>4. Autoritetet kompetente përgjegjëse për zbatimin e Rregullores sipas procedurave të Notifikimit të Byrosë së Përhershme të Sekretariatit të Konferencës së Hagës, brenda kompetencave të tyre do të marrin parasysh rekomandimet përkatëse të Komisioneve Speciale të Konferencës së Hagës.</p> <p>5. Autoritetet kompetente, 30 ditë pas hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje, vendosin në përdorim formularin unik dhe të standardizuar të kërkesës për lëshimin e certifikatës apostile.</p>	<p>Procedures.</p> <p>3. Ministry of Foreign Affairs and the Ministry of Internal Affairs shall issue by laws governing the procedures of verification and legalization of public documents for all those requests whose destination (receiving) state will be the states which have <i>‘objected’</i> the accession of the Republic of Kosovo in the Apostille Convention and countries that are not members of this Convention.</p> <p>4. Competent Authorities responsible for the implementation of the Regulation, according to the notification procedures of the Permanent Bureau of the Hague Conference shall, within their competencies, consider the respective recommendations of the Special Commissions of Hague Conference.</p> <p>5. The Competent authorities shall start using the unique and standardized form of the request for issuing the apostil certificate within 30 days after entry into force of this Regulation.</p>	<p>3. Ministarstvo inostranih poslova i Ministarstvo unutrašnjih poslova, donose podzakonske akte koji regulišu procedure provere i legalizacije javnih dokumenata za sve one zahteve u kojima su države odredišta (prihvatanja) one države koje su izrazile <i>‘Protivljenje’</i> za pristupanje Republike Kosovo Haškoj konvenciji za pečat Apostille kao i za države ne-članice Konvencije.</p> <p>4. Nadležni organ koji je odgovoran za sprovođenje Uredbe prema procedurama overavanja sekretarijata stalnog biroa Haške konferencije će u okviru svojih nadležnosti uzeti u obzir relevantne preporuke Specijalnih komisija Haške konferencije.</p> <p>5. Nadležni organi obavezna da u roku od trideset (30) dana, od dana stupanja na snagu ove Uredbe, stave na upotrebu jedinstveni i standardizovani formular zahteva za izdavanje sertifikata Apostille.</p>
--	--	---

<p style="text-align: center;">Neni 16 Hyrja në fuqi</p> <p>Kjo Rregullore hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas nënshkrimit nga ana e Kryeministrit.</p> <p style="text-align: right;">Isa Mustafa</p> <hr style="width: 20%; margin-left: auto; margin-right: auto;"/> <p style="text-align: center;">Kryeministër i Republikës së Kosovës</p> <p style="text-align: right;">27 dhjetor 2016</p>	<p style="text-align: center;">Article 16 Entry into force</p> <p>This Regulation shall enter into force seven (7) days after the signature by Prime Minister.</p> <p style="text-align: right;">Isa Mustafa</p> <hr style="width: 20%; margin-left: auto; margin-right: auto;"/> <p style="text-align: center;">Prime Minister of the Republic of Kosovo</p> <p style="text-align: right;">27 December 2016</p>	<p style="text-align: center;">Član 16 Stupanje na snagu</p> <p>Ova Uredba stupa na snagu sedam (7) dana od potpisivanja od strane Premijera.</p> <p style="text-align: right;">Isa Mustafa</p> <hr style="width: 20%; margin-left: auto; margin-right: auto;"/> <p style="text-align: center;">Premijer Vlade Republike Kosovo</p> <p style="text-align: right;">27 decembar 2016</p>
---	---	---

SHTOJCA I/ANEKS I/ANNEX I

APOSTILLE

(Convention de La Haye du 5 Octobre 1961)

1. Shteti/Država/Country: REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/
REPUBLIC OF KOSOVO

Ky dokument publik / Ovaj javni dokument/This public document

2. është firmosur nga/ je potpisan od strane/has been signed by

3. i cili vepron në cilësinë e/ koji deluje u svojstvu /acting in the capacity of

4. dhe mban vulën/pullën / i sadrži pečat/markicu / bears the seal/stamp of

Vërtetohet/ Potvrđuje se /Certified

5. në/u/at 6.data/datum/ date.....

7. nga/od/by

8. nr/br/no

9. vula/pulla/pečat/ markica/ seal/stamp 10. nënshkrimi/potpis/signature:

Model i certifikatës 100x100 cm